FLETË INFORMUESE MBI PROJEKTET

Instituti i Kërkimeve Urbane

Projekti për Forcimin e Rrjeteve Rinore për Rritjen e Pjesëmarrjes në Hartimin dhe Zbatimin e Politikave Rinore

Konteksti i projektit

Në kuadër të mbështetjes dhe angazhimit të organizatave dhe grupeve rinore në proceset vendim marrëse, Ministria e Kultures, Turizmit, Rinisë dhe Sporteve, me mbështetjen e organizatës UNICEF, hartoi dhe organizoi një set trajnimesh 2 ditore në qytetet Tiranë, Durrës dhe Elbasan. Ekspertët e Institutit për Kerkime Urbane hartuan dhe zbatuan konceptet themelore të angazhimit të komponentit rinor në proceset vendim marrëse si:

1. Aftësimin e organizatave rinore për përmbushjen e misionit të tyre;
2. Funksionimin e organizatat rinore si përfaqësues të grupeve që përfaqësojnë;
3. Pajisjen e drejtuesve të organizatave rinore me aftësi specifike në fushën e Lidershipit dhe te Shkrimit te Projekteve.

Në kuadër të mbështetjes dhe angazhimit të organizatave dhe grupeve rinore në proceset vendim marrëse, Ministria e Kultures, Turizmit, Rinisë dhe Sporteve, me mbështetjen e organizatës UNICEF, hartoi dhe organizoi një set trajnimesh 2 ditore në qytetet Tiranë, Durrës dhe Elbasan. Instituti i Kerkimeve Urbane (URI) i përzgjedhur si zbatues i këtij aktiviteti, realizoi një trajnim sa më të kuptueshëm dhe ndëraktiv për pjesëmarrësit.

Temat e projektit

Temat e pregatitura nga ekspertët e URI-t prezantonin konceptet bazë dhe themelore të angazhimit të komponentit rinor në proceset vendim marrëse duke pasur si synime të përgjithshme:

- Aftësimin e organizatave rinore për përmbushjen sa më efikase të misionit për të cilin janë ngritur;
- Organizatat rinore të funksionojnë si përfaqesues të grupeve që përfaqësojnë
- Drejtuesit e organizatave rinore fitojnë aftësi specifike në fushën e Lidershipit dhe te Shkrimit te Projekteve.

Fushat kryesore të projektit

1. Lidershipi rinor (roli dhe profili i një lideri rinor);
2. Si të shkruajmë një projekt (konceptimi, formulimi dhe paraqitja e një projekti);
3. Advokimi i organizatave rinore (Si të mbrojmë idetë, idealet dhe të percjellim mesazhet tona në nivelet vendim marrëse).

Rekomandimet

Aktiviteti përfundoi me një sërë rekomandimesh si domosdoshmeria e organizimit më të shpeshtë të këtyre aktiviteteve, të vlefshme jo vetëm për përvetësimin e dijeve mbi konceptet moderne Europiane për funksionimin efikas të organizatave rinore, por edhe për shkëmbimin e ideve dhe alternativave për gjenerimin e politikave konstruktive në shërbim të misionit të tyre. Gjithashtu, të rinjte shprehen vlefshmërinë e parimeve të Lidershipit dhe Avokimit të cilat do t'u shërbenin jo vetëm për formimin e pergjithshëm të tyre por edhe në praktikat e afërta si punesimi mbas studimeve, realizimi i një karriere progresive e të bazuar në parimet e ndershmërisë, etj. Gjithashtu, nje emërues i përbashkët i këtyre organizatave ishte dhe domosdoshmëria e prezantimit dhe trajtimit të kuadrit ligjor të BE-së me fokus të veçantë mbi pjesëmarrjen rinore si element shtytës i shoqërisë.

FAKTET KRYESORE

PARTNERET:

- ✓ UNICEF

KOHËZGJATIA:

2011-2012

PËRFITUESIT:

- ✓ Të rinjtë në qytetin e Tiranës, Durrësit, Elbasanit

KONTAKT:

Zana Vokopola
Drejtore Ekzekutive

Instituti I Kërkimeve Urbane

Rr. Asim Vokshi, Nd.14
Hyrja 11, Ap. 56
Tiranë
Tel: +355 4 2256840
E-mail: uri@uri.org.al
Web: www.uri.org.al

Rreth IKU

Që nga viti 1999 Instituti i Kërkimeve Urbane (IKU) ka dhënë rezultate të mëdha për projektet dhe programet e zhvillimit të realizuara në të gjithë Shqipërinë. Puna jonë ynë kryesore përqendrohet në zhvillimin e komunitetit, forcimin e qeverisjes vendore, mbrojtjen e mjedisit, decentralizimin dhe shërbimet publike. Ne kryejmë studime, lobojmë qeverinë, trajnojmë njësitë e qeverisjes vendore, rrisim aksesin e publikut në informacion, dhe lidhim partnerët në punën për zhvillim.. IKU ka punuar me donatorë si USAID, Bashkëpunimi Zviceran, Ambasada Holandeze, UNDP, Banka Botërore, BE, SIDA, Shoqëri të Hapur / Fondacioni Soros, etj.